



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 11 prill 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të  
Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Lejimin e Rihapjes së Paraqitjes së  
Provave të Saj**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së të akuzuarit**  
Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim lidhur me kërkesën e Mbrojtjes për leje për apelim dhe/ose rishikim të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Lejimin e Rihapjes së Paraqitjes së Provave të Saj.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 mars 2024, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Lejimin e Rihapjes së Paraqitjes së Provave të Saj (Vendimi i Kundërshtuar), me të cilin rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për të rihapur paraqitjen e provave të veta për të thirrur W02540-n të jepte dëshmi gojore në gjykim.<sup>1</sup>
2. Më 26 mars 2024, Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht Mbrojtja dhe i akuzuari) dorëzoi një kërkesë për leje për apelimin dhe/ose për rishikim të Vendimit të Kundërshtuar (Kërkesa).<sup>2</sup>
3. Më 4 prill 2024, pas shkurtimit të afateve kohore,<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) iu përgjigj Kërkesës (Përgjigja).<sup>4</sup> Mbrojtësi i Viktimave nuk dorëzoi përgjigje dhe as Mbrojtja nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

## II. PARASHTRIME

### A. MBROJTJA

4. Mbrojtja paraqet dy kërkesa alternative. Së pari, Mbrojtja kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me dy pika (bashkërisht, dy pikat):

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00813, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Rihapjen e Paraqitjes së Provave të Saj*, 19 mars 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua po në të njëjtën ditë, [F00813/RED](#).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00823, Mbrojtja, *Kërkesë për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Rihapjen e Paraqitjes së Provave të Saj*, 26 mars 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 2 prill 2024, F00823/RED.

<sup>3</sup> Trupi Gjykues shkurttoi afatet për përgjigje dhe kundërpërgjigje me anë të postës elektronike; KSC-BC-2020-04, CRSPD168, Mesazh me postë elektronike nga Zyra Administrative drejtuar palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave, ku komunikoheshin urdhrat e Trupit Gjykues, 27 mars 2024, në orën 13:34.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00826, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelim ose Rishikim të Vendimit F00823*, 4 prill 2024, konfidenciale.

- (i) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor kur i refuzoi të akuzuarit mjet juridik ndaj shkeljes së rëndë të detyrimit për nxjerrjen e materialeve nga ana e Prokurorisë (pika e parë); dhe
- (ii) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor kur refuzoi t'i lejonte Mbrojtjes rihapjen e paraqitjes së provave të veta për të thirrur një dëshmitar që mund të jepte dëshmi shfajësuese, për të cilat Mbrojtja u vu në dijeni vetëm në fazën aktuale për shkak të detyrimeve të Prokurorisë për nxjerrjen e materialeve (pika e dytë).<sup>5</sup>

5. Mbrojtja parashton se: (i) dy pikat janë të apelueshme, sepse janë mjaftueshmërisht konkrete, të sakta, dhe burojnë drejtpërdrejt nga Vendimi i Kundërshtuar;<sup>6</sup> (ii) dy pikat ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit, si edhe në rezultatin e mundshëm të gjykimit, sepse ndikojnë drejtpërdrejt mbi të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë, duke e privuar atë nga një mjet juridik i efektshëm dhe nga mundësia për të paraqitur mbrojtje të plotë në rast se nuk i lejohet t'i bëjë pyetje W02540-s;<sup>7</sup> dhe (iii) një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Apelit lidhur me dy pikat do ta avanconte ndjeshëm procesin, pasi kështu do të garantohej se procesi po vijon në përputhje me garancitë themelore të drejtësisë.<sup>8</sup>

6. Sa i përket pikës së parë, Mbrojtja parashton më konkretisht se Trupi Gjykses nuk ka ofruar asnjë mjet juridik të efektshëm ndaj shkeljes së detyrimeve për nxjerrjen e materialeve nga ana e ZPS-së.<sup>9</sup> Ajo shton më tej se kjo shkelje ka dëmtuar rëndë Mbrojtjen dhe se meriton korrigjim të menjëhershëm për të shmangur gabim gjyqësor.<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 4.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 16 dhe në vijim.

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 21-23 (në f. 8). Trupi Gjykses thekson se kur i referohet numrit të faqeve, ka ndjekur numërtimin fillestar të faqeve që ka përdorur Mbrojtja në Kërkesë.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 24-25 (në f. 8).

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 19, 21 (në f. 4-5).

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 17, 21-23 (në f. 4-5).

7. Sa i përket pikës së dytë, Mbrojtja parashtron më konkretisht se, Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e vlerës provuese së provave të W02540-s si dhe kur konstatoi se mospërputhjet mes provave në fjalë dhe dëshmisë së TW4-01-shit ishin të vogla.<sup>11</sup> Sipas Mbrojtjes, mospërputhjet në fjalë janë të mëdha dhe dëshmia e W02540-s bie ndesh me dëshminë e TW4-01-shit, që është dëshmitari më i rëndësishëm i ZPS-së.<sup>12</sup> Për të njëjtat arsye, Mbrojtja parashtron më tej se Trupi Gjykses gaboi kur vlerësoi se dëshmia e W02540-s ka relevancë të kufizuar për çështjen.<sup>13</sup> Së fundi, Mbrojtja pretendon se rihapja e paraqitjes së provave për dhënien e dëshmisë nga një dëshmitar shtesë nuk do të cenonte të drejtën e të akuzuarit për t'u gjykuar pa vonesë të paarsyeshme, por pikërisht duke mos e bërë këtë dhe duke mos e lejuar të paraqesë prova shfajësuese cenohen të drejtat e tij.<sup>14</sup> Mbrojtja thekson se gabimet e mësipërme kanë dëmtuar të akuzuarin, pasi Mbrojtja e tij nuk pati mundësi t'i përdorte provat shfajësuese gjatë paraqitjes së provave të saj, çka çoi në shkeljen e të drejtave të të akuzuarit.<sup>15</sup>

8. Së dyti, si alternativë, Mbrojtja kërkon rishikimin e konstatimeve në Vendimin e Kundërshtuar për të parandaluar padrejtësinë.<sup>16</sup>

## B. ZPS-JA

9. ZPS-ja parashtron, në përgjigje, se Kërkesa duhet rrëzuar pasi: (i) asnjë prej dy pikave nuk është e apelueshme, por Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me Vendimin e Kundërshtuar dhe kërkon të debatojë përsëri pika tashmë të rrëzuara prej Trupit Gjykses;<sup>17</sup> (ii) dy pikat nuk kanë gjasë të ndikojnë ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të

---

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 29, 31.

<sup>12</sup> Kërkesa, para. 29, 31.

<sup>13</sup> Kërkesa, para. 32.

<sup>14</sup> Kërkesa, para. 34.

<sup>15</sup> Kërkesa, para. 31, 34.

<sup>16</sup> Kërkesa, para. 5, 26 (në f. 9).

<sup>17</sup> Përgjigja, para. 1-7.

shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit;<sup>18</sup> dhe (iii) një vendim i menjëhershëm i Apelit nuk do të avanconte thelbësisht procesin në këtë fazë, por përkundrazi do ta zgjaste atë në mënyrë të panevojshme.<sup>19</sup> Sa i përket kërkesës së Mbrojtjes për rishikim të vendimit, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja nuk ka dhënë arsye pse duhet të rishikohen konstatimet e Trupit Gjykses.<sup>20</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 21 dhe 45 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 77 dhe 79 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

### IV. ANALIZË

#### A. KËRKESA PËR LEJE PËR APELIM

11. Fillimisht, Trupi Gjykses përfshin përmes referimit standardin për miratimin e lejes për apel të përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores dhe të shtjelluar në vendime të mëhershme.<sup>21</sup>

12. Trupi Gjykses vëren se dy pikat e parashtruara nga Mbrojtja kanë shumë ngjashmëri pasi të dyja lidhen me mjetin juridik që duhet t'i ofrohet Mbrojtjes,

---

<sup>18</sup> Përgjigja, para. 8-10.

<sup>19</sup> Përgjigja, para. 11-13.

<sup>20</sup> Përgjigja, para. 1, 14.

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-04, F00587, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence's Request for Leave to Appeal and/or Reconsideration of F00538](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit F00538), publik, para. 8, 11-12; F00401, Trupi Gjykses I, [Decision on Request for Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala](#) (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala) 24 janar 2023, publik, para. 13-20; F00116, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Application for Leave to Appeal "Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës) 29 nëntor 2021, publik, para. 11-13.

nëse ka, si rezultat i mospërmbushjes nga ZPS-ja të detyrimit për nxjerrjen e materialeve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i shqyrtoi së bashku.

13. Trupi Gjykses konstatoi se Mbrojtja nuk ka identifikuar asnjë pikë të apelueshme. Sa u takon dy pikave, Mbrojtja thjesht përsërit argumentet që ka bërë më parë, të cilat u vlerësuan dhe rrëzuan nga Trupi Gjykses. Sa i përket pikës së parë, Mbrojtja përsërit se nxjerrja me vonesë e provës së W02540-s “ka cenuar rëndë Mbrojtjen” dhe se Trupi Gjykses gaboi duke mos trajtuar ose ofruar mjet juridik (alternativ).<sup>22</sup> Trupi Gjykses e vlerësoi këtë argument në Vendimin e Kundërshtuar dhe konstatoi se, ndonëse prova e W02540-s u nxor me vonesë, “asnjë dëm nuk iu shkaktua Mbrojtjes” e për rrjedhojë nuk nevojitej ndonjë mjet juridik, pasi prova kishte natyrë kumulative, relevancë të kufizuar dhe mospërputhjet mes provës së W02540-s dhe dëshmisë së TW4-01-it ishin të vogla.<sup>23</sup> Mbrojtja po shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar<sup>24</sup> dhe thjesht nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjykses duke u përpjekur të rihapë juridikisht këtë pikë.

14. Po ashtu, lidhur me pikën e dytë, Mbrojtja përsërit se prova e W02540-s bie ndesh me dëshminë e TW4-01-it dhe se ka “shumë mospërputhje” mes dy dëshmitarëve dhe se këto mospërputhje janë “madhore”.<sup>25</sup> Edhe njëherë, këto argumente janë trajtuar nga Trupi Gjykses në Vendimin e Kundërshtuar. Trupi Gjykses ka rrëzuar shprehimisht argumentet me konstatimin se “– përkundër parashtimeve të Mbrojtjes– mospërputhjet mes provës së W02540-s dhe dëshmisë së TW4-01-it janë të

---

<sup>22</sup> Kërkesa, para. 17, 19, 21.

<sup>23</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 19-21.

<sup>24</sup> Trupi Gjykses thekson se kjo nuk është hera e parë që Mbrojtja nuk pasqyron saktë konstatimet e Trupit Gjykses; shih KSC-BC-2020-04, F00401, Trupi Gjykses I, [Decision on Request for Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala](#) (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala), 24 janar 2023, publik, para. 27, 40, 68; F00592, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence Request for certification to appeal the “Decision on the Specialist Prosecutor’s Requests to admit the evidence of TW4-02 and TW4-04 under Rule 153 of the Rules”](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores), 17 korrik 2023, publik, para. 20, 24.

<sup>25</sup> Kërkesa, para. 29, 31, 32.

vogla dhe [...], në thelb, prova e W02540-s konfirmon gjerësisht dëshminë e TW4-01-it".<sup>26</sup> Pra, edhe njëherë Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjykses dhe po përpiqet ta rihapë edhe njëherë juridikisht çështjen.

15. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se dy pikat nuk janë pika të apelueshme që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar. Meqenëse nuk është përmbushur elementi i parë i standardit, atëherë Trupi Gjykses nuk e sheh të nevojshme të trajtojë pjesën tjetër të kërkesave sipas nenit 45(2) të Ligjit dhe rregullës 77(2) të Rregullores dhe refuzon miratimin për dy pikat.

#### B. KËRKESA PËR RISHIKIM

16. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se në mënyrë që të merret parasysh kërkesa për rishikim në bazë të rregullës 79 të Rregullores, pala ose pjesëmarrësi që bën kërkesën duhet të demonstrojë ose (i) ekzistencën e arsytimit qartësisht të gabuar ose (ii) që rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë. Faktet dhe argumentet e reja që kanë dalë që prej lëshimit të Vendimit të Kundërshtuar mund të jenë relevante për këtë vlerësim. Për shkak të natyrës së jashtëzakonshme, rishikimi nuk mund të përdoret si një mjet juridik i zakonshëm (si "një rrugë tjetër për të paraqitur apel") për të korigjuar të metat në një vendim apo për t'iu shmangur pasojave të pafavorshme. Rrjedhimisht, thjesht mospajtimi me rezultatin apo me arsytimin e një vendimi nuk mjafton që vendimi të rishikohet.<sup>27</sup>

17. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja nuk jep asnjë arsyetim (të mëtejshëm) për rishikimin e kërkuar, përveç arsyeve për të mbështetur lejen për apelim. Mbrojtja nuk thellohet më tej me standardin juridik sipas rregullës 79 të Rregullores për të demonstruar ose arsyetim qartësisht të gabuar ose një arsye të vlefshme që Trupi Gjykses të rishikojë Vendimin e Kundërshtuar, por thjesht shpreh mospajtimin me

---

<sup>26</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 20.

<sup>27</sup> KSC-BC-2020-04, F00587, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence's Request for Leave to Appeal and/or Reconsideration of F00538](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit F00583, publik, para. 23 dhe referencat në të).

